



Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, neni 22, paragrafi 1, alineja 3, dhe neni 30, paragrafi 1, alineja 2, nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal (“Gazeta zyrtare e RMV” nr.24/21), neni 30 nga Rregullorja për metodologji për përgatitje të dokumenteve planore për zhvillim rajonal (“Gazeta zyrtare e RMV” nr. 219/210), neni 2, paragrafi 1, alineja 3 nga Rregullorja për punë e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor nr.01-99/1 e datës 22.07.2021, Këshilli në mbledhjen e mbajtur në datë 16.03.2022 e shqyrtoi dhe e miratoi këtë:

**PLANI AKSIONAR VJETOR PËR VITIN 2022
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM TË
RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR**

HYRJE

Plani aksionar për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor bazohet në parimet kryesore të përcaktuara në dokumente strategjike nacionale, rajonale dhe në nivel lokal. Gjatë kësaj, angazhimet e institucionit dalin dhe janë të lidhura me realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor. Në këtë dokument bazik për zhvillim të rajonit për periudhën 2021-2025 janë përcaktuar qëllimet afatmesme, prioritetet dhe masat, me çka përmes këtij Plani aksionar, përmes projekteve, rritet niveli i vetë realizimit të Programit të rajonit planor Jugperëndimor. Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për periudhën 2021-2025 është përgatitur gjatë vitit 2020 dhe e njëjta është miratuar nga Këshilli për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor në fillim të vitit 2021 me pajtueshmëri paraprake nga ana e Këshillit për ZHBR të RVM-së.

Në këtë dokument janë paraqitur dhe projektet rajonale të cilat Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor i dorëzoi deri te BZHR për vitin 2021/2020 dhe për të cilat janë nënshkruar Marrëveshje për realizim deri në fund të vitit 2021.

Gjithashtu janë paraqitur edhe projekte të cilat janë financuar nga ana e Ministrisë për bujqësi, pylltarisë dhe ujërave dhe Agjencia për mbështetje financiare të zhvillimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, për të cilat pritet thirrje për propozim projekte gjate vitit 2022.

Pjesë përbërëse e këtij dokumenti janë edhe aktivitetet që do të financohen nga Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) në bashkëpunim me Ministrinë për vetëqeverisje lokale përmes projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” , - faza e II për realizim. Në kuadër të këtij projekti janë paraparë më shumë aktivitete për mbështetje të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor si dhe shema e Grantit për projekte investuese.

Për Biznes Qendrën në kuadër të Qendrës për zhvillim të RPJP është siguruar kofinancim nga ana e MVL dhe SDC për organizimin e eventeve, punëtorive, programe me vauçerë përmes FIZHT, promovime dhe trajnime për biznes sektorin.

Duke marrë parasysh rëndësinë rajonale janë përgatitur edhe projekte si ndërtim të kolektorit nga Kalishta deri në Radozhdë të cilën e implementon komuna e Strugës. Gjithashtu të parashtruara janë edhe projekte për përgatitjen e dokumentacionit teknik me të cilat Qendra planifikon të aplikoj tek Ministria për vetëqeverisje lokale për mjete nga Programi për konkurrencë dhe tejkalimin e dispariteteve për vitin 2022.

Për përgatitjen e Planit Aksionar është përdorur Metodologjia gjegjësisht Rregullorja për përgatitjen e dokumenteve planore. Dhe sipas kësaj aktivitet janë ndarë në qëllime strategjike , prioritet dhe masa nga Programi për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2021-2025. Të gjitha aktivitet janë të paraqitura në mënyrë tabelore dhe për secilën është përgatitur projekt , aktivitet, afat kohor , mjetet financiare të nevojshme, indikatorët , partnerët për realizim si dhe burimet financiare. Është vendosur edhe perspektiva gjinore.

Qëllimi afatmesëm 1: Përmirësimi i ekonomisë dhe paritetit gjinor përmes shfrytëzimit të përparësive komparative të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitete investuese në NVM me teknologji, njohuri dhe inovacione të reja, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri në ambientin jetësor, bujqësinë dhe zhvillimit rural

Prioriteti 1.1 Rritja e konkurrencës së ekonomisë rajonale

Nr.r.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohëzgjatja	Shuma	Indikatorët	Partnerë/Financ,
1.1.4	Nxitja e mundësive për shfrytëzimin e burimeve të financimit të brendshme dhe të jashtme të NVM	Biznes Qendra për përkrahje dhe shërbime për Biznes sektorin	1.Veprim si zyrë rajonale e FIZHT për kontakte 2.Përkrahje teknike dhe informim të biznes sektorit për thirrjet aktive 3.Programe me vauçerë për ndërtimin e kapaciteteve të biznes sektorit 4.Shpallja e listës së burimeve të mundshme të financimit të biznes sektorit nga Qeveria dhe të tjerë 5. informim për bizneset të udhëhequra nga gratë për mundësi financiare	12 muaj	360.000	1. Fonde të shfrytëzuara nga burime financimi vendase dhe të jashtme 2.Numri i nisjeve të reja start-up bizneseve 3. numri i NVM të udhëhequra nga gratë nga burime financiare vendase dhe të jashtme nga MVL	KZHRPJP, QZHRPJP, NJVL, NVM, FIZHT, MVL, SDC

Prioriteti 1.2 Fuqizimi dhe modernizimi i sektorit të NVM

1.2.4	Nxitja e shkëmbimit të përvojave dhe njohurive ndërmjet subjekteve nga vendi dhe jashtë.	Biznes Qendra për përkrahje dhe shërbime për Biznes sektorin	1.Promovimi i sipërmarrësve të suk-sesshëm nga rajoni/ Intervista me sipërmarrësit për shkëmbimin e historive të suksesit/përgatitja e video klipeve të promovuara në rrjetet sociale 2. inspirimi dhe vendosja e bashkëpunimit me Dhomat e Tregtisë, akselerator dhe universitetet	12 muaj	120.000	1.Realizimi i shitjeve të produkteve tradicionale 2.Numri i të punësuarve në ndërmarrjet e përkrahura(meshkuj/femra) 3.Numri i kompanive të cilët kanë siguruar financa nga programe të ndryshme 4.Numri i NVM-ve të themeluara dhe të drejtuara nga gratë që kanë siguruar mjete financiare nga programe të ndryshme.	QZHRPJP, NJVL, Sektori i Biznesit, MVL, SDC
-------	------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------	---------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------

Qëllimi afatmesëm 1: Përmirësimi i ekonomisë dhe paritetit gjinor përmes shfrytëzimit të përparësive komparative të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitete investuese në NVM me teknologji, njohuri dhe inovacione të reja, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri në ambientin jetësor, bujqësinë dhe zhvillimit rural

Prioriteti 1.3 Rritja e investimeve në rajon

Nr.r.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohëzgjatja	Shuma	Indikatorët	Partnerë
1.3.2	Nxitja e takimeve të bashkësive të bizneseve me investitorë potencial	Biznes Qendra për përkrahje dhe shërbime për Biznes sektorin	1.Promovimi i Biznes Qendrës në rrjetet sociale, shpallje të rregullta në FB me informacione të nevojshme për kompanitë	12 muaj	100.000	1. numri i shpalljeve 2. numri i reaksioneve/pëlqimeve 3. numri i komenteve	QZHRPJP, NJVL, Sektori i Biznesit, MVL, SDC

Prioriteti 1.4 Përmirësimi i hapësirave përmes zhvillimit të infrastrukturës

1.4.1	Ndërtimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës rrugore në rajon	Zhvillimi i infrastrukturës publike në zonat rurale, Investime në infrastrukturën lokale rrugore	Ndërtimi i rrugëve qasëse deri te tokat bujqësore në RPJP	6 muaj	5.083.374	1. gjatësia e rrugëve të ndërtuara 2. numri i personave (meshkuj/femra) shfrytëzues të infrastrukturave rrugore 3. numri i personave (meshkuj/femra) të cilët kanë qasje më të mirë në arsim, shëndetësi , mbrojtje sociale Si rezultat të ndërtimit lokal të rrjetit rrugor	QZHRPJP,MBPU Prog.kap.sub. për zhvillim të RP Komunat Debërcë, M.Brod
1.4.1	Ndërtimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës rrugore në rajon	Përkrahje zhvillimit ekonomik rajonal përmes turizmit, kulturës dhe veprim. tjera ekon.	Rikonstruktimi i rrugës Dame Gruev (dega 2,3 dhe 4) si dhe pjesë nga rr. Momqilo Jordanoiski në Ohër	8 muaj	18.153.851	1. gjatësia e rrugëve të ndërtuara 2. numri i personave (meshkuj/femra) shfrytëzues të infrastrukturave rrugore 3. numri i personave (meshkuj/femra) të cilët kanë qasje më të mirë në arsim, shëndetësi , mbrojtje sociale Si rezultat të ndërtimit lokal të rrjetit rrugor	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR

Qëllimi afatmesëm 1: Përmirësimi i ekonomisë dhe paritetit gjinor përmes shfrytëzimit të përparësive komparative të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitete investuese në NVM me teknologji, njohuri dhe inovacione të reja, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri në ambientin jetësor, bujqësinë dhe zhvillimit rural

Prioriteti 1.4 Përmirësimi i hapësirës përmes zhvillimit të infrastrukturës

Nr.r.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohëzgjatja	Shuma	Indikatorët	Partnerë
1.4.1	Ndërtimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës rrugore në rajon	Mbështetja e zhvillimit rajonal dhe zhvillimit ekonomik përmes turizmit kulturës dhe aktiviteteve të tjera ekonomike	Rikonstruktimi i rrugëve për këmbësor „ 27 mars „ Vëllezërit Milladinovci dhe rr. 1 në pjesën e vjetër të qytetit të Strugës	8 muaj	12.995.663	1. gjatësia e rrugëve të ndërtuara 2. numri i personave (meshkuj/femra) shfrytëzues të infrastrukturave rrugore 3. numri i personave (meshkuj/femra) të cilët kanë qasje më të mirë në arsim, shëndetësi , mbrojtje sociale Si rezultat të ndërtimit lokal të rrjetit rrugor	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR
1.4.1	Ndërtimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës rrugore në rajon	Mbështetja e zhvillimit rajonal dhe zhvillimit ekonomik përmes turizmit kulturës dhe aktiviteteve të tjera ekonomike	Rikonstruktimi i rrugës nga Qendra Zhupë deri në fshatin Bajramovci	8 muaj	8.000.000	1. gjatësia e rrugëve të ndërtuara 2. numri i personave (meshkuj/femra) shfrytëzues të infrastrukturave rrugore 3. numri i personave (meshkuj/femra) të cilët kanë qasje më të mirë në arsim, shëndetësi , mbrojtje sociale Si rezultat të ndërtimit lokal të rrjetit rrugor	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR
1.4.1	Ndërtimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës rrugore në rajon	Ndërtimi / rikonstruktimi i rrugëve në mjediset rurale të rajoni	Ndërtimi rikonstruktimi i rrugëve të lidhura me vendbanimet në rajon	8 muaj	23.600.000	1. gjatësia e rrugëve të ndërtuara 2. numri i personave (meshkuj/femra) shfrytëzues të infrastrukturave rrugore 3. numri i personave (meshkuj/femra) të cilët kanë qasje më të mirë në arsim, shëndetësi , mbrojtje sociale Si rezultat të ndërtimit lokal të rrjetit rrugor	QZHRPJP, NJVL, APFBZHR, Programi për zhvillim rural

Qëllimi afatmesëm 1: Përmirësimi i ekonomisë dhe paritetit gjinor përmes shfrytëzimit të përparësive komparative të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitete investuese në NVM me teknologji, njohuri dhe inovacione të reja, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri në ambientin jetësor, bujqësinë dhe zhvillimit rural

Prioriteti 1.4 Përmirësimi i hapësirës përmes zhvillimit të infrastrukturës

Nr.r.	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohëzgjatja	Shuma	Indikatorët	Partnerë
1.4.3	Ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale në rajon	Ndërtimi i kolektorit Kalishtë-Radozhdë	Ndërtimi i kolektorit për ujërat e zeza dhe lidhja e tij me SPUZ Vranishtë	12 muaj	35.670.000	1. Gjatësia e sistemeve të kanalizimit të realizuara dhe të ri konstruktuar 2. Numri i personave (meshkuj/femra) shfrytëzues të sistemit të kanalizimit	Komuna Strugë , Qeveria e RMV, MAJPH, Donatorë
1.4.4	Përgatitja e dokumentacionit teknik për infrastrukturën	Përgatitja e dokumentacionit teknik në komunat e rajonit	1.përgatitja e dokumentacionit teknik për infrastrukturën rrugore 2. Përgatitja e dokumentacionit teknik për infrastrukturën komunale 3. Përgatitja e dokumentacionit teknik për energji infrastrukturë nga BRE	10 muaj	6.000.000	1. Gjatësia e infrastrukturës rrugore për të cilën është përgatitur dokumentacion teknik 2.Gjatësia e infrastrukturës komunale për të cilën është përgatitur dokumentacion teknik 3. Sipërfaqja e objekteve për të cilën janë projektuar infrastrukturë energjetike.	QZHRPJP, NJVL, MVL, Programi për Konkurrencë dhe tejkalimin e dispariteteve

Qëllimi afatmesëm 2: Arsim konkurrues sipas nevojave të bashkësive lokale, bashkësive afariste dhe tregut të punës, përmirësimi i barazisë gjinore dhe përmirësimi i qasjes deri te arsimimi dhe shërbimet sociale të qytetarëve, në drejtim të zvogëlimit të ikjes së rinjve dhe de popullimit, me punësim produktiv dhe mirëqenie sociale për fëmijët, personat e dëmtuar dhe social të varur dhe kategoritë e dëmtuara

Prioriteti 2.5 Qasje e barabartë e shërbimeve për të gjithë qytetarët në rajon

Nr.r	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohëzgjatja	Shuma	Indikator	Partnerë
2.5.1	Rritja e kualitetit të shërbimeve sociale dhe qasjes për të gjithë kategoritë e qytetarëve	Organizimi i evenimenteve për rritjen e kapaciteteve të Qendrës dhe Këshillit për zhvillim	Organizimi i 3 evenimenteve – Trajnime/ punëtori (nga 1 eveniment në kuartalin e 2, 3 dhe 4)	9 muaj	85.000	1. numri i evenimenteve të realizuara 2. Numri i pjesëmarrësve (meshkuj/femra) në eveniment	QZHRPJP, NJVL, Këshilli për zhvillim i RPJP, MVL, SDC
2.5.1	Rritja e kualitetit të shërbimeve sociale dhe qasjes për të gjithë kategoritë e qytetarëve	Organizimi i forumeve rajonale	1.organizimi i dy forumeve për Grant shemën e SDC 2. Organizimi i dy forumeve për Programin e BZHR të MVL/BZHR	8 muaj	536.000	1. Numri i pjesëmarrësve (meshkuj/femra) në forume 2. Numri i projekt ideve të krijuara të cilat plotësojnë nevojat e meshkujve/femrave 3. Numri i koncepteve të përpunuara	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, SDC, BZHR, Njësia e projektit ZHBRQI
2.5.1	Rritja e kualitetit të shërbimeve sociale dhe qasjes për të gjithë kategoritë e qytetarëve	Projekt investues me elemente të inkluzionit social dhe digjitalizim	Intervenime infrastrukturore, inkluzioni social dhe digjitalizim	18 muaj	15.000.000	1. Numri i përdoruesve të infrastrukturës së ndërtuar/rindërtuar 2. Numri i përdoruesve (meshkuj/femra) nga kategori të ndryshme	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, SDC, Njësia e projektit ZHBRQI
2.5.4	Inkluzioni social për kategori sociale te qytetareve të përjashtuar nga shoqëria përmes hapjeve të qendrave ditore për kujdes	Përmirësimi i energjisë efikase në objektet publike dhe zvogëlimi i ndotjes së mjedisit jetësor në RPJ.	Renovimi i objekteve për pushim, rehabilitimi dhe rekreaciteti i personave invaliditet fizik në Ohër (OQ Mobilnost)	8 muaj	1.775.784	1.Numri i personave (meshkuj/femra)të cilët i shfrytëzojnë objektet në nivel vjetor 2. Sipërfaqja e objekteve të rikonstruara 3. Përqindja e personave me aftësi të kufizuara të cilët i shfrytëzojnë objektet	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR

Qëllimi afatmesëm 3: Turizmi, trashëgimia natyrore dhe kulturore, ambienti jetësor i mbrojtur dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë janë faktorë për zhvillim të qëndrueshëm të njohur në RPJP

Prioriteti 3.3 Nxitja dhe zhvillimi i formave alternative të aktiviteteve dhe shërbimeve turistike

Nr.r	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohëzgjatja	Shuma	Indikatorë	Partnerë
3.3.5	Zhvillimi i bizneseve lokale në mbështetje të aktiviteteve të turizmit të brendshëm në rajon	Mbështetja e zhvillimit ekonomik rajonal përmes turizmit, kulturës dhe veprimtaritë të tjera ekonomike	Rregullimi i oborrit rreth objektit të ri konstruktuar-qendra turistike në Vevqan	10 muaj	4.627.263	1. sipërfaqja e hapësirës së rregullt 2. Qarkullimi i realizuar nga aktivitetet turistike në zonat rurale 3. Numri i shfrytëzuesve (meshkuj/femra) të qendrës turistike në Vevqan	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR
3.5.1	Krijimi i një sistemi të integruar rajonal për menaxhimin me mbeturinat	Përmirësimi i energjisë efikase në objektet publike dhe zvogëlimi i ndotjes së mjedisit jetësor në RPJ.	Furnizimi i kontejnerëve për grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave në komunën e Pillasnicës	8 muaj	960.000	1. Numri i kontejnerëve për grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave 2. Numri i shfrytëzuesve të kontejnerëve për grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave 3. Numri i personave të trajnuar/informuar (meshkuj/femra) për selektimin e mbeturinave	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR
3.5.5	Masa për mbrojtjen nga ndotja e ujërave	Përmirësimi i energjisë efikase në objektet publike dhe zvogëlimi i ndotjes së mjedisit jetësor në RPJ.	Përfundimi i kanalit të Pesjakut për pranim dhe trajtimin të ujërave të rrëmbyeshme dhe përfundimi paralel i kanalizimit fekal në komunën e Makedonski Brod	8 muaj	2.288.551	1. Gjatësia e kanalaeve të ndërtuara/rindërtuara për bartjen atmosferike 2. Gjatësia e ndërtuar e kanalizimit fekal 3. Numri i shfrytëzuesve (meshkuj/femra) për sistemin e kanalizimit	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR
3.6.2	Reduktimi i përdorimit të lëndëve djegëse fosile si energji në industri dhe familje	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike dhe zvogëlimi i ndotjes së ambientit jetësor në RPJP	Renovimi dhe sistem i ri për ngrohje qendrore në objektin e zjarrfikësve me rëndësi rajonale me masa për efikasitet energjetik në qytetin e Dibrës	8 muaj	4.629.548	1.Sipërfaqja e objekteve publike të rinovuara; 2.Numri i masave të kryera për përmirësimin e EE; 3.Kapacitetet e sistemit të instaluar për nxehe	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR

Qëllimi afatmesëm 3: Turizmi, trashëgimia natyrore dhe kulturore, ambienti jetësor i mbrojtur dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë janë faktorë për zhvillim të qëndrueshëm të njohur në RPJP

Prioriteti 3.6 Përmirësimi i efikasitetit energjetik dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë

Nr.r	Masa	Projekte	Aktivitete	Kohëzgjatja	Shuma	Indikator	Partnerë
3.6.3	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike dhe zvogëlimi i ndotjes së ambientit jetësor në RPJP	Efikasitet energjetik dhe rikonstruktimi i SHF “Faik Konica”, shkolla rajonale në fshatin Baçishtë, Komuna e Kërçovës	8 muaj	6.188.573	1. Sipërfaqja e objektit të rinovuar 2. Numri i masave të zbatuara për përmirësimin e EE	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR
3.6.3	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike	Përmirësimi i efikasitetit energjetik në objektet publike dhe zvogëlimi i ndotjes së ambientit jetësor në RPJP	Ndërtimi i Shtëpisë në f.Trebenishtë – faza e dytë, Komuna e Debërcës	8 muaj	3.500.000	1. Sipërfaqja e objektit të rinovuar 2. Numri i masave të zbatuara për përmirësimin e EE	QZHRPJP, NJVL në RPJP, MVL, BZHR

Mjetet e nevojshme për realizim

Nr.r.	Qëllimi afatmesëm	Shuma në MKD	Shuma në EURO
1	Përmirësimi i ekonomisë dhe paritetit gjinor përmes shfrytëzimit të përparësive komparative të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitete investuese në NVM me teknologji, njohuri dhe inovacione të reja, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri në ambientin jetësor, bujqësinë dhe zhvillimit rural	110.082.888	1.789.966
2	Arsim konkurrues sipas nevojave të bashkësive lokale, bashkësive afariste dhe tregut të punës, përmirësimi i barazisë gjinore dhe përmirësimi i qasjes deri te arsimimi dhe shërbimet sociale të qytetarëve, në drejtim të zvogëlimit të ikjes së të rinjve dhe de popullimit, me punësim produktiv dhe mirëqenie sociale për fëmijët, personat e dëmtuar dhe social të mvarur dhe kategoritë e dëmtuara	17.396.784	282.874
3	Turizmi, trashëgimia natyrore dhe kulturore, ambienti jetësor i mbrojtur dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë janë faktorë për zhvillim të qëndrueshëm të njohur në RPJP	22.193.935	360.877
	GJITHSEJ	149.673.607	2.433.717

Ndërveprim ndërmjet parterëve për zbatimin e programit

Realizimi i Programit, përmes masave dhe aktiviteteve, duhet të sjellë drejtë përmirësimin të kualitetit jetësor të popullsisë në rajonin planor Jugperëndimor. Kjo nënkupton përmirësimin e infrastrukturës, krijimi i kushteve për hapje të bizneseve të reja, rritja e mundësive ekonomike të popullsisë, zvogëlimi i emigrimeve nga mjediset rurale tek urbane dhe nga mjediset urbane jashtë vendit. Zhvillimi i barabartë rajonal në tërësi duhet të ndihet në kuadër të komunave të rajonit planor Jugperëndimor përmes zhvillimit të tyre të përgjithshëm ekonomik dhe social.

Partnerët, veçanërisht përfaqësuesit e komunave të rajonit janë aktiv në qasjen për realizimin e Programit, veçanërisht gjatë implementimit të aktiviteteve projektuese. Gjithashtu të gjithë partnerët dhe palët e interesuara nga rajoni janë të përfshirë në proces nga fillimi të cilët përmes sesioneve të forumeve i identifikojnë problemet dhe nevojat duke propozuar zgjidhje përmes aktiviteteve projektuese të cilat janë në pajtueshmëri me Programin për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor. Komunitat në të cilat zhvillohen aktivitetet projektuese kanë përfaqësues të cilët janë pjesë e ekipit, dhe japin kontributin e tyre nga fillimi i aktiviteteve (futje në punë të operatorit ekonomik) dhe deri në përfundim gjatë së cilit bëhet pranim teknik dhe procesverbal. Për sa i përket intervenimeve ndërtimore, komunitat sigurojnë mbikëqyrës në ndërtim, dhe për këtë arsye janë faktor kyç në realizimin e këtij lloji aktiviteti. Kur realizohen aktivitetet e këtij lloji të shërbimeve për përgatitjen e dokumentacionit teknik atëherë komunitat e përgatisin pjesën e detyrës projektuese për territorin e vet dhe gjatë përgatitjes janë vazhdimisht të përfshirë dhe aktiv.

Në këtë mënyrë, një ndërveprim i tillë aktiv me partnerët jep një ndikim pozitiv në zhvillimin e komunave dhe reflekton në rritjen e përgjithshme të rajonit planor Jugperëndimor dhe të vendit. Programi paraqet bazë për bashkëpunim më dinamik ndërkombëtar, përmirësimi i marrëdhënieve të tyre me mjedisin si dhe bashkëpunim me rajonet planore të tjera. Përfshirja e të gjitha kapaciteteve të disponueshme në nivel rajonal duhet të zvogëlojë dallimet sociale të komunave, rajonit në tërësi, si dhe ndërmjet mjediseve urbane dhe rurale.

Mënyra e informimit të publikut

Qendra për zhvillim rajonal planor Jugperëndimor për të gjitha aktivitetet e saj e informon publikun përmes WEB faqes www.southwestregio.mk. Gjithashtu përmes FB profilit të Qendrës ku vazhdimisht shpallin informacione rreth aktiviteteve të Qendrës, si dhe aktivitetet e komunave në kuadër të rajonit. Profili i FB-kut gjithashtu përdoret edhe për komunikim të rregullt me sektorin e biznesit ku përmes të cilës shpërndahen informacione për mundësitë e financimit, për ndihmën teknike për përgatitjen e aplikacioneve dhe sigurimin e mentorëve. Në profilin e FB-kut të Qendrës shpërndahen edhe informacione në formën e historive të suksesit të biznesit të rajonit që synojnë të inkurajojnë dhe të tjerët veçanërisht të rinjtë dhe gratë e rajonit të fillojnë bizneset e tyre.

Mbi të gjitha, Qendra të gjitha informacionet kryesore i ndan me partneret edhe në formë elektronike, organizimi i eventeve informuese, si dhe takime individuale me palët e interesuara. Sigurisht që për informimin e publikut përdoren edhe mediat lokale, rajonale dhe kombëtare në formë të

shkruar dhe elektronike. Qendra i kushton vëmendje të veçante prezantimit të të gjitha aktiviteteve në mënyrë më transparente, e cila do të mundësojnë përfshirjen e më shumë pjesëmarrësve për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Analiza e riskut

Dy vitet e fundit e gjithë bota u përball me pandeminë nga COVID19, dhe për këtë Qendra për zhvillim rajonal pati ndërprerje për numrat restriktive. Për faktin që pandemia ende vazhdon të jetë dhe asnjë nuk siguron që do të përfundojë , dhe gjatë vitit 2022 ky rrezik ekziston. Ashtu si në të kaluarën edhe këtë vit do të përdoren mënyra/aktivitete alternative në përputhje me protokollet e dhëna nga Ministria për shëndetësi, por në çdo rast kufizon mundësitë për zbatimin e planeve të plota.

Gjithashtu edhe situata politike në vend mund të ketë ndikim negativ duke sjellë vonesa të vendimeve të rëndësishme të cilat janë jetike për funksionimin të gjithë palëve të interesuara të cilët përdorin fondet buxhetore dhe mjetet e donatorëve.

Si rrezik për zbatimin e Programit mund të jenë edhe fatkeqësitë e motit ose fatkeqësitë natyrore që janë të paparashikueshme të cilat mund të prishin ndjeshëm procesin e zbatimit të aktiviteteve të projektit.

Realizimi i Programit mund të ketë një efekt të reduktuar derisa nuk sigurohen mjete të mjaftueshme financiare për realizimin e aktiviteteve të projektit. Pandemia dhe kriza energjetike sollën rritje të ndjeshme të çmimeve të mallrave, shërbimeve dhe punëve, kështu që gjatë zbatimit të projekteve të aplikuara shumë kohë më parë mund të përballemi me mungesë të fondeve për shkak të diferencës ndërmjet çmimeve të planifikuara dhe atyre aktuale.